



Buletini Mjedisor

PËR NJË FUSHATË NDRYSHE

MINISTRI KOKA: LETËR TË HAPUR KANDIDATËVE PËR KRYETARË BASHKISH DHE KOMUNASH

Ditët e para të Majit, sapo zyrtarisht u hap fushata elektorale për zgjedhjet lokale, ministri i Mjedisit, z.Lefter Koka, inicioi një letër të hapur për të gjithë kandidatët që aspirojnë të zgjidhen nga elektorati shqiptar për të drejtuar komunat dhe bashkitë e vendit.

Në këtë letër të hapur, ministri Koka i ftoi kandidatët të bënin një fushatë ndryshe, ku në takimet e tyre elektorale të përfshinin dhe idetë dhe zgjidhjet që ata mendonin për të përmirësuar mjedisin në territorin që ata aspirojnë të administrojnë.

“Me përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit besoj se është në dinjitetin dhe profesionalizmin Tuaj, kthimi i vëmendjes

drejt mjedisit, pasi në mbarë vendin ai përbën një rëndësi jetike dhe ndikon jo vetëm në zonat rurale, por edhe deri brenda shtëpive të familjeve në zonat urbane”.

Gjithashtu, ministri Koka solli në vëmendjen e kandidatëve se “Kryetarët e njësjesë të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ” (referuar ligjit 10463 dt.22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” pikës 12 të nenit 21).

Gjithashtu, komunat dhe bashkitë, në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike realizojnë grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave dhe në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”

gërmën “c” të pikës 3 të nenit 10.

Nisur nga kjo, dëshiroj që në fushatën Tuaj të sillni përpara qytetarëve programe të qarta se si do e kryeni Ju, përmeshjen e këtij detyrimi ligjor, se cili është vizioni Juaj për të siguruar një mjedis të pastër e të shëndetshëm”.

Ministri Koka i siguroi kandidatët se mjedisi nuk ka ngjyrim politik, ndaj u falenderoj për mirëkuptimin dhe ju siguroj që Ministria e Mjedisit, pas 21 qershorit, do jetë në krahu të fituesve, duke punuar së bashku për të siguruar një mjedis të përshatshëm për të gjithë shqiptarët

Pas letrës së hapur, ministri Koka mori jo vetëm përgjigje për këtë risi në politikën Shqiptare, por mori dhe angazhime konkrete, si rasti i kandidatit Arben Malo, kandidat për Bashkinë e Kolonjës i Aleancës për Shqipërinë Evropiane.

DITA BOTËRORE E SHPENDËVE MIGRATORË



Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Migratorë, Ministria e Mjedisit dhe

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, zhvilluan aktivitet promovues në Qendrën e Vizitorëve të Zonës së Mbrojtur (Rezervë Natyrore e Menaxhuar) të Kune-Vainit në Lezhë.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga pushteti dhe komuniteti lokal, nxënës të shkollave të zonës së Lezhës, OJF mjedisore, punonjës të zonave të mbrojtura dhe shërbimit pyjor të qarkut, etj.

Të pranishmit theksuan rëndësinë e ndërgjegjësimit të shoqërisë për vlerat dhe rëndësinë e ruajtjes së këtyre shpendëve anembanë globit. Gjatë aktivitetit u fol mbi arritjet e një viti moratorium të gjuetisë si dhe u shpërndanë postera dhe fletpalosje informuese mbi shpendët migratorë.

Dita Botërore e Shpendëve Migratorë që në 2006 është shpallur data 9 dhe 10 Maj të çdo viti, ditë ku ndërmerren një sërë aktivitetesh

sensibilizuese për mbrojtjen e këtyre shpendëve në të gjithë vendet, ku ato qëndrojnë me sezone. Kjo ditë synon të inspirojë konservimin e jetës së egër në dy drejtime - si për llojet migratore, ashtu dhe për habitatet e tyre.

Në këtë ditë është nevojë që ne të evidentojmë faktin se edhe vendi ynë i bashkohet familjes së madhe të vendeve që jo vetëm e përkujtojnë dhe e festojnë këtë ditë, por edhe që janë hedhur hapa konkrete për konservimin e jetës së egër.

Vendi ynë është palë që nga viti 2001 si në Konventën e Specieve Migratore (CMS), ashtu edhe në Marrëveshjen për Ruajtjen e Shpendëve të Ujit Shtegëtarë Afrikanë-Euroaziatikë (AEWA) dhe plotëson rregullisht detyrimet që rrjedhin prej tyre. Plotësimi i kuadrit tonë ligjor e përafërimi me atë të BE-së, raportimi periodik në strukturat e konventës dhe marrëveshjes, organizimi i veprimtarive dhe aktiviteteve që i shërbejnë ruajtjes së jetës së egër, janë disa nga këto detyrime që përmesh vendi ynë në kuadër të mbrojtjes së shpendëve migratorë.

Motoja e ditës së Shpendëve Migratorë për këtë vit ishte : “Energjia – Bëje miqësore me

shpendët”, për të shprehur nevojën që rrugët të cilat sigurojnë rritjen e energjisë, të ecin në mënyrë të tillë, që të sigurojnë ruajtjen e specieve migratore, rrugët e tyre të fluturimit dhe habitatet e tyre sikurse në mbarë botën, edhe në vendin tonë.

Shpallja vitin e kaluar, e moratoriumit të gjuetisë në vendin tonë për një periudhë dy-vjeçare, me qëllimin e frenimit të rënies së mëtejshme të popullatave të faunës së egër, është dëshmi e vullnetit që ka treguar qeveria për të ruajtur biodiversitetin dhe faunën e egër si pjesë përbërëse të tij, ku padyshim shpendët migratorë zënë një vend shumë të rëndësishëm.

Është fakt që, si pasojë e kësaj iniciative për të bllokuar gjuetinë, ne kemi sot tregues të shumtë që popullatat e shpendëve të egër vendas dhe atyre migatore, po përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Krijimi së fundmi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, është një premisë tjetër që habitatet, veçanërisht ato ujore të vendit tonë, si habitate dhe areale nga më të kërkuarat e specieve migratore, të ruhen dhe promovohen nga stafi i tyre i posaçëm.

NË KËTË NUMËR:

DITA BOTËRORE E SHPENDËVE MIGRATORË FQ 1

ZONAT E MBROJTURA NË NJË PANAIR VLERASH FQ 2

LEJET MJEDISORE FQ 3-4

22 MAJ, DITA BOTËRORE E BIODIVERSITETIT FQ 4

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmeshja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime të mirëqenitë atëgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionion publik”.

ZONAT E MBROJTURA NË NJË PANAIR VLERASH



Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës u zhvillua në datat 10 - 16 Maj 2015 dhe u shoqërua me një numër aktivitetesh, ndër të cilat edhe Panairi Argjiro FestOn, ku morën pjesë institucionet qendrore dhe lokale, ente publike e biznese private.

Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Qendrës Kombëtare të Panairëve, organizoi Panairin e Zonave të Mbrojtura, në datat 10, 11 dhe 12 Maj 2015. Me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ofruan në panair informacion për biodiversitetin dhe

vlerat natyrore e mjedisore të zonave të mbrojtura për Parkun Kombëtar të Prespës, Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, Zona e Mbrojtur Sazan - Karaburun, Zona e Mbrojtura e Alpeve. Gjithashtu, veç informacionit të dhënë nëpërmjet botimeve, fletëpalosjeve dhe posterave, u mundësua dhe sjellja e produkteve të rralla, që prodhohen në këto zona.

Qëllimi i këtij panairi ishte sensibilizimi i komunitetit, jo vetëm për vlerat e atyre zonave, por edhe për domosdoshmërinë e ruajtjes dhe konservimit të këtyre ekosistemeve, si pasuri të vyerat të rajoneve dhe vendit tonë.

Ky panair i zonave të Mbrojtura Shqiptare u mundësua

jo vetëm nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, por dhe në bashkëpunim me donatorët që kanë financuar projekte në këto zona të mbrojtura, si KfW, UNDP, GIZ, REC si dhe Rrjeti i Pyjeve Komunalë/CNVP.

Panairi qëndroi i hapur në tri ditët e para të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës.

Gjatë këtyre ditëve, ky panair u vizitua jo vetëm nga qytetarët e Gjirokastrës të cilët patën një javë të zhurmshme në qytetin e tyre, por u ndoq dhe nga vizitorë të tjerë nga e gjithë Shqipëria dhe të huaj të ardhur për këtë Festival të këngës popullore Shqiptare.

FESTIVALI I FILMIT MJEDISOR

Me iniciativën e Ministrisë së Mjedisit dhe përfaqësuesit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, më 17 Maj 2015 filloi edicioni i tretë i Festivalit të Filmit Mjedisor në Shqipëri.

Këtë vit, ky festival u zhvillua nga data 17 deri në 23 maj në shtatë qytete të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Elbasan, Përmet, Korçë, Vlorë dhe Pukë.

Në ceremoninë e hapjes morrte pjesë zëvendësimi -nistria e Mjedisit znj. Oljana Ifti, e cila në fjalën e saj përshëndetëse theksoi se "Ky festival është një rrugë komunikimi midis artit dhe shoqërisë për të përcjellë mesazhin që është koha për ndryshimin e perspektivës sonë mjedisore. Natyra na kujton të mendojmë se kush jemi në të vërtetë, për të riparë marrëdhëniet tona me vetveten, njëri-tjetrin dhe mjedisin që na rrethon, për të na kujtuar se ne jemi banorë të kësaj toke".

Zoti Clive Rumbold, i Ngarkuari me Punë i Delegationit të BE-së në Shqipëri, theksoi ndër të tjera se këtë vit festivali ofron një program të përzgjedhur me shumë kujdes nga organizatorët e këtij eventi gjë që do të mundësojë reflektimin e shikuesve mbi vlerën e mjedisit dhe përgjegjësitë e përbashkëta për ta mbrojtur atë.

Kryetari i jurisë së festivalit, aktori Mirush Kabashi, foli mbi prurjet e reja të këtij edicioni dhe mesazhin ndërgjegjësues të këtij eventi duke shpallur më pas hapjen e konkurimit.

Dita e parë e Festivalit filloi me filmat "Quagga" dhe "Heritage Fight". Gjatë ditëve të Festivalit të Filmit Mjedisor do të projektohen 42 filma shqiptarë dhe të huaj. Artistët e huaj pjesëmarrës ishin nga Gjermania, Italia, Spanja, Bullgaria, Kroacia, Turqia, Austria, Holanda, Franca dhe Suedia, etj.

Filmat në konkurim janë me metrazh të gjatë dhe metrazh të shkurtër. Një seksion i këtij festivali janë edhe ai i EFA Lab e cila synon të mbështesë producentë që të realizojnë filma me subjekt mjedisin në të gjithë zonën e Ballkanit duke ju mundësuar projektimin e tyre për të parën herë në këtë festival filmi. Një tjetër seksion i këtij festivali është edhe EFA

School që synon të mbështesë prezantimin e iniciativave edukative për mjedisin, të realizuara nga shkollat në të gjithë Shqipërinë. Në pjesë të rëndësishme të Festivalit të Filmit Mjedisor janë dhe aktivitetet e tjera si workshop, forume dhe konferenca me tema të ndryshme mjedisore.

DISA NGA FILMAT QË PO SHFAQEN NË KINEMA

LUFTA E TRASHËGIMISË

Ka ende disa vende të pacënuara në botë, të paprekura nga industrializimi dhe urbanizimi. Por, për sa kohë?



Broome është një qytet i vogël në rajonin Kimberley, shkretëtira e fundit e madhe e Australisë. "Woodside", një kompani multi-miliardere dhe prodhuesit më të mëdhenj të gazit natyror të lëngshëm në Australi kanë vendosur të instalojnë këtu impiantin e dytë më të madh në botë të gazit natyror në gjendje të lëngshme. Nëse ky projekt bëhet realitet, kjo do të thotë fund i kulturës dhe trashëgimisë aborigjene. HERITAGE FIGHT ngre pyetje, dëgjon, citon shkencëtarë, aktivistë, politikanë dhe biznesmenë, të gjithë të vendosur të luftojnë dhe të mbrojnë atë çka është e paçmuar për ta, të shtyrë nga një ndërgjegjësim i jashtëzakonshëm kolektiv. Një vështrim bashkëkohor i mitit të Davidit dhe Goliatit.

EN QUETE DE SEAS

Të zhgënjyer nga gjendja e botës, dy miq fëmijëri shkojnë të takojnë njerëzit që bëjnë ndryshimin, në kërkim të mirëkuptimit.

Ky udhëtim nismëtar rreth botës, do të jetë për ta një mundësi për të vënë në pikëpyetje besimet që i japin formë shoqërisë moderne, me sa duket e bllokuar. I ndërtaur me takime të pagjasa, dyshime dhe gëzime, ky film sjell një mesazh shprese për ata që ndihen të pashpresë para televizorit të tyre. Ndryshimi po ndodh në botë, është një ndryshim ndërgjegjësimi, i motivuar nga nevoja për të jetuar në harmoni me veten dhe me sferën e jetës.

AKULLI I ZI

Kur anija "Arctic Sunrise" e organizatës "Greenpeace" nisi udhëtimin për të protestuar kundër

shpimeve të para për naftë në Oqeanin Arktik, asnjëri nga njerëzit në bord nuk mund ta dinte çfarë do të ndodhte. Mberthyer në shënjestrën e forcave speciale ruse, ekuipazhi 'Arctic 30' pushtoi titujt kryesorë në mbarë botën, duke u përballur me 15 vjet burg dhe duke u gjendur në qendër të një debati të ashpër ndërkombëtar.

NJË DITË PËRGJATË VJOSËS

I ashtuquajtur "Thesari i egër i Evropës", Lumi Vjosa është ENDE i panjohur për shumë dhe ende thelbësor për njerëzit që banojnë pranë tij. Një pjesë e madhe e itinerarit të Vjosës mbulon zonën e Përmetit, dhe është pa dyshim një pjesë e rëndësishme e identitetit të këtij rrethi. Teksa rrjedh përmes territorit, është e vështirë të përfytyrosh se si do të ishte jeta e banorëve vendas, që janë rritur me këtë lumë, pa Vjosën.

Ruajtja e gjendjes natyrore të këtij burimi të çmuar ndërthuret me zhvillimin e integruar të zones, si e tërë. Është themelore për ekonominë e zonës, një simbol me rëndësi për jetën shoqërore të banorëve, si dhe përfaqëson gjithashtu një pikënisje emocionuese për të shtruar rrugën drejt idesë së qëndrueshme për turizmin.

MJEDISI DHE MINIERAT NË BURIMET E LUMIT MAT

Filmi synon të tregojë ndikimet mjedisore të kromit apo minierave në burimet e lumit Mat në rajonin e Krastës, në rrethin e Bulqizës. Gjatë viteve të fundit sektori i minierave është zhvilluar intensivisht, por pa kriter mjedisor. Nga vëzhgimet në terren gjatë 28 - 29 marsit 2015 u vu re një ndikim i madh mjedisor, si: zhvendosje të mbetjeve minerare në rrjedhën e lumit, një qasje e rrallë rrugore shoqëruar me fragmentarizim të habitatit dhe erozion të detyruar; humbje të tokës produktive dhe kërcënim i specit të bimës endemike të listës së kuqe (Crocus serpentina). Veprimtaritë minerare përdorin gjithashtu lëndë drusore, çka është një barrë e shtuar për pyjet e prera ekzistuese në zonë.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS MAJ 2015

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	ISAKU	VNMP Shfrytëzim mineral kromi, galeri	Objekt i "Galeria 12,42", Zona "D", Bulqize, Rreth Bulqizë	Vendim Paraparak
2	KURTI - A sh.p.k	VNMP Shfrytëzim mineral kromi, galeri	Objekti "Galeria Nr. 1205&36, Zona 1, Bulqizë	Vendim Paraparak
3	EGEMA	VNMP Strukturë shërbimi dy kate magazinë, katër kate zyra dhe një kat parkim nëntokë	Kashar, Tiranë	Vendim Paraparak
4	BASHKIA HIMARË 1592	VNM P Ndërtimi i rrjetit te brendshëm Dhërmi, burimi "Fresko"	Fshat i Dhërmi, burimi "Fresko", Bashkia Himarë , Qarku Vlorë.	Vendim Paraparak
5	"KUARCI BLACE"	VNM P Aktivitet minerar nga shfrytëzimi i rezervave të mbetura në ish minierën e kromit Mënik	Fshati Menik, Rrethi Librazhd, Qarku Elbasan	Vendim Paraparak
6	BASHKIA HIMARË	VNM P Ujësjetësi Dhërmi	Dhërmi, Himarë, Vlorë,	Vendim Paraparak
7	VËLLEZËRIT HYSA	VNM P Nyje fraksionimi	Pazhok, Gostimë, Elbasan	Vendim Paraparak
8	SPITALI RAJONAL BERAT	VNM P Menaxhim i mbetjeje spitalore në Spitalin Rajonal Berat	Berat	Vendim Paraparak
9	FITAL SHPK	VNM P Repart prodhimi dhe ambiente ndihmëse një katëshe	Bathore, Tiranë	Vendim Paraparak
10	GJASHTË TITANËT	VNM TH Shfrytëzim minerali Fe-Ni	Zona minerare 1462, Objekt i "Gur i shpuar" Cervernake, Pogradec, Korçë.	Refuzim Deklarate
11	TEKI	VNM TH Shfrytëzim minerali kromi	Objekti "Theken ", zona minerare Nr.5 32/3, Martanesh, Buqizë, Dibër	Deklaratë Mjedisore
12	FONDACIONI SEMA	VNM P Ndërtim i objektit Univer "Beder"	Sauk, Tiranë.	Vendim Paraparak
13	ART - ISAKU	VNM P Repart industriale	Durrës	Vendim Paraparak
14	KANTINA PALI	VNM P Strukturë për verë	Prush, Tiranë	Vendim Paraparak

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	EROGERT	VNM P Rritja e shpendëve dhe therja e tyre	Radostinë, Dermenas, Fier	Refuzim
2	RRUGA URA ASFALTIM NR.2 EL-BASAN	VNM P Mbledhje, grumbullim, riciklim të plastikës, skrapit, skorjes, sfungjerit, mbetjeje urbane polisterolit.	Bradashesh, Elbasan	Refuzim
3	HYDRO SETA	VNM P Ndërtim i HEC-it "Seta-4", pjesë e kaskadës së përroit të Setes	Përroi i Setës, Arras, Dibër.	Refuzim
4	KOMUNA GRABIAN	VNM P Rikonstruksion i rrugës Cerem Sektor-Tre Urat-Staravec- Gërmenj i madh-Tre urat-Autostrada Rrogzhinë- Lushnjë	Lushnjë, Fier	Vendim VNM Paraprake
5	SEA SALT ALBANIA	VNM P Ndërtim tetejo për mbulimin e lëndës së parë, kripës së jodizuar.	Sallomone, Xhafzotaj, Durrës	Vendim VNM Paraprake
6	"BREGU"	VNM P Godinë banimi dhe shërbimi	Rruga "Mihal Grameno" Tiranë	Vendim VNM Paraprake
7	BASHKIA KORÇË	VNM P Rikonstruksion i rrugës Liceistët	Korçë	Vendim VNM Paraprake
8	LUBIMA	VNM TH Shfrytëzim i mineralit të kromit.	Zona 433-4, Objekti "Maja e Micekut, Selishtë, Dibër	Deklaratë Mjedisore
9	ARTI	VNM P Linjë fraksionimi inertesh	Volloder, Lukovë, Sarandë, Vlorë	Vendim VNM Paraprake
10	SHOQATA ARSIMORE KULTURORE DHE HUMANTARE "SELIMJE"	VNM P Ndërtim i Medresesë 4 Kate.	Peshkopi, Dibër	Refuzim
11	XHILI 2003	VNM P ndërtim i 2 kapanoneve	Rrashbull, Durrës	Vendim VNM Paraprake
12	UJËSJELLËS -KANALIZIME POGRADEC	VNM P Ndërtim linje të re ujësjetësi	Buçimas, Pogradec, Korçë	Vendim VNM Paraprake
13	S & S CONSTRUCTION	VNM P Ndërtim Hote l- Restorant	Dajt, Tiranë	Refuzim
14	CINAR -SAN TIRANA BRANCH	VNM TH Ndërtim Hec- Poçam	Poçem, Kutë, Fier	Deklaratë Mjedisore

LEJET MJEDISORE MAJ 2015

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1.	ANGELS ALBANIA AGIM SULA III.2.B	Grumbullim, magazinim, seleksionim, transport, përpunim të mbetjeve plastike, grumbullim të mbetjeve metalike me qëllim riciklimi	Rruga "Josif Pashko", Tiranë	Miratim
2.	AMERICAN HOSPITAL (LC-2815)	Spital	Spital Ushtarak, Tiranë	Miratim
3.	AMERICAN HOSPITAL (LC-2816)	Spital	Rruga e Dibrës, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë	Miratim
4.	BENAKS-94	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Objekti "Leshnicë", Rrethi Pogradec, Qarku Korçë	Miratim
5.	IKONA	III.2.B.Përpunim dhe riciklim i skorjeve të aluminit nga industria metalurgjike dhe mbetje urbane të parrezikshme.	Lagjia Kushtrimi, Vlorë	Miratim
6.	RENCI	III.2.B. Transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme (ujërave të zeza, llumra)	Ura Vaigurore, Berat	Refuzim
7.	ISAKU	Minierat nëntokësore	Bashkia Bulqizë, Dibër	Miratim
8.	JODY-KOMPANY	Ndryshim	Finiq, Delvinë, Vlorë	Refuzim

22 MAJI—DITA BOTËRORE E BIODIVERSITETIT



Ministria e Mjedisit dhe Bashkimi Evropian në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit organizuan një takim me fokus në zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në fushën e biodiversitetit në Shqipëri.

Në këtë takim merrnin pjesë, zëvendësministria e Mjedisit Olijana Ifi, Ambasadori Italian, z. Massimo Gaiani, përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, z. Antoine Avignon, përfaqësues nga donator të ndryshëm, që kanë projekte në fushën e biodiversitetit si përfaqësues nga GIZ, UNDP, Banka Botërore etj. Gjithashtu, kishte përfaqësues nga shoqëria civile, nga fakulteti i Shkencave të Natyrës etj.

Prezantimi i parë u mundësua nga znj. Caterina Carugati për projektin e Bashkimit Evropian, "Natura 2000". Në këtë prezantim znj. Carugati i njohu të pranishmit me kontributin që do jepte ky projekt për biodiversitetin në Shqipëri. Natyra 2000 është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zhvillohet në një sërë vendesh të rajonit tonë. I krijuar si një rrjet që në vitin 2001, ka si objektiv ndalimin e humbjes së biodiversitetit në vendet e Bashkimit Evropian.

Ky projekt ambicioz buron nga dy Direktivat e rëndësishme të Bashkimit Evropian që është Direktiva e Zogjeve dhe Direktiva e Habiteteve, të cilat detyrojnë që palët (vendet e Bashkimit Evropian dhe ato vendet që dëshirojnë të antarësohen) të ndërmarin veprime për mbrojtjen e habitateve dhe specieve në të gjitha vendet e BE-së. I gjithë ky proces është jo vetëm ndërmarrje shkencore

por i shoqëruar dhe nga veprime ligjore për ruajtjen e biodiversitetin e rajonit si dhe për të menaxhuar këtë fushë, me fokus kryesor dhe përbushjen e interesit të popullatave që jetojnë në këto mjedis.

Prezantimi i dytë u mbajt nga përfaqësuesi i GIZ, z. Ralf Peveling, i cili e vuri theksin në Ruajtjen e Biodiversitetit në Shqipëri— sfidat dhe idetë e gabuara. Në prezantimin e tij, z. Peveling solli disa elementë që duhet të mbahen parasysh, për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Më pas, prezantimet vijuan me znj. Elvana Rama, përfaqësuese e Drejtorisë së Biodiversitetit në Ministrinë e Mjedisit, e cila bëri një përmbledhje të arritjeve që kanë ndodhur gjatë vitit 2014-2015 në fushën e biodiversitetit. Ajo theksoi nismat ligjore dhe institucionale që ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit, ajo vuri theksin veçanërisht në Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, çka pritet të sjellë një përmirësim në menaxhimin e këtyre zonave dhe paralelisht në ruajtjen e biodiversitetit në tërësi. Gjithashtu, znj. Rama theksoi se jo vetëm po ndryshon menaxhimi i këtyre zonave, por po vazhdon dhe shtimi i sipërfaqeve të mbrojtura siç është puna që po bën Ministria e Mjedisit për shpalljen zonë e mbrojtur për pjesën e Alpeve.

Z. Zamir Dedej, drejtor i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, i njohu të pranishmit me objektivat, që ka kjo Agjenci Kombëtare, si dhe njohu të pranishmit me pritshmëritë për kthimin e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, në zona të mirëmenaxhuara.

Më pas, prezantimi u mbajt nga znj. Violeta Zuna, e cila

solli për të pranishmit punën që po bëhet për krijimin e zonave të mbrojtura detare në Shqipëri si një eksperiencë e re. Zonja Zuna është drejtuese e një projekti për zonat e mbrojtura bregdetare në Shqipëri e mundësuar me financim të UNDP-së.

Gjithashtu, në këtë takim u prezantua dhe një vështrim i përgjithshëm për Kopshtin Botanik në Tiranë, nga znj. Ermelinda Mahmutaj, e cili shpjegoi për të pranishmit rolin që luan ky institucion shkencor në vite. Kopshtit botanic, gjatë këtyre viteve i është besuar monitorimi i situatës së florës në vendin tonë.

Interesant dhe këndvështrimi në prezantimin e fundit të këtij takimi që u mbajt nga arkitekti z. Kreshnik Merxhani, i cili solli në vëmendje ndërthurjen që duhet të kenë në zona turistike midis arkitekturës dhe mjedisit, pasi shumë shpesh ndërhyrjet që bëhen në zonat kulturele si kështjella apo monumente kulture mund të ndikojnë në pakësimin e habitateve që gjenden brenda tyre. Shembull ishte Kalaja e Gjirokastrës, e cila shumë shpesh nga mënyra se si ndriçohet kishte sjellë largimin e shpendëve të ndryshme, të cilët mikromjedisin ku jetojnë e kërkojnë më pak të ndriçuar.

Gjithashtu, ai theksoi se bashkëpunimi mund të jetë i vlefshëm pasi vizitorët mund të marrin veç informacionit turistik dhe një informacion mjedisor mbi florën dhe faunën që gjendet brenda kësaj zone turistike.



THËNIA E MUAJIT

“Përpiquni ta lini Globin, një vend më të mirë se e gjetët”

Sidney Shelton

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT
 Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



DIVJAKA “MIRËPRET” BRESHKAT E DETIT

Divjaka, si zakonisht është bregdeti mikëpritës i breshkave të ujit. Edhe në javën e dytë të Majit, peshkatarët që peshkojnë në këtë segment të detit Adriatik kishin gjetur në rrjetat e tyre një breshkë të llojit caretta, dhe menjëherë informuan Prof. Idriz Haxhiu, i cili pasi e vëzhgoi specien, përcaktoi se breshka është e llojit “Caretta Caretta”. Kjo breshkë ishte e matrikular dhe me një GPS funksionale mbi kurriz. U zbulua se emri i saj ishte Koronisja dhe GPS i ishte vendosur më 25.06.2013 qershor, në Greqinë perëndimore në gjirin Amvrokikos.

Po kjo breshkë ishte kapur më parë më datë 12.04.2015 në Patok, Lezhë, dhe ishte lëshuar në det një ditë më vonë. Pasi u bënë matjet dhe procedurat standarde nga specialistët, breshka u lëshua përsëri në det. Moratoriumi mbi mbrojtjen e faunës tokësore dhe asaj detare, jo vetëm ka mbarështuar këtë faunë, por ka ndërgjegjësuar edhe komunitetin e gjahtarëve e të peshkatarëve për ruajtjen e saj.



TË RINJTË SHQIPTAR DHE GJERMAN “GJALLËROJNË” PARKUN KOMBËTAR TË PRESPËS

Parku Kombëtar i Prespës në javën e tretë të Majit u kthye dhe në një qendër edukuese për një grup të rinjsh shqiptar dhe gjerman.



Fëmijët e shkollave të mesme të të dy vendeve, gjatë vizitës dy ditore u njohën me vlerat mjedisore dhe kulturore të këtij Parku, i cili shtrihet në të tri vendet: Shqipëri, Greqi dhe Maqedoni. Ata në ditën e parë patën mundësi të vëzhgonin dhe njihnin nëpërmjet syrit të lirë por dhe teleskopëve shpendët e kësaj zone si dhe të njiheshin me habitatet që zhvilloheshin në këtë zonë.

Gjithashtu, atyre i'u shpjegua dhe cilësia e ujërave të liqenit të Prespës, elementët dhe monitorimi që mundësohet për të kuptuar cilësinë e ujit të këtij liqeni.

Në ditën e dytë të vizitës nxënësit identifikuan vetë të gjitha speciet dhe habitatet që shihnin në këtë Park nëpërmjet një seminari aktiv të organizuar nga punonjësit e Parkut por dhe përfaqësuesit e Projektit Kombëtar të Prespës, projekt i financuar nga KfW-ja. Eksperienca të tilla, jo vetëm që e bëjnë më të gjallë jetën në Park, por mundëson dhe marrjen e qëndrueshme të njohurive në fushën e biologjisë për nxënësit shqiptar, ndërsa për studentët e huaj mund të ndihmojë në rritjen e numrit të turistëve në të ardhmen për bukuritë që ofron ky park.



PRAKTIKAT MË TË MIRA TË PESHKIMIT

Më 15 Maj 2015, në kuadër të programit "Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Pellgun e Mesdheut" u zhvillua workshopi me temë



"Praktikat më të mira të peshkimit në lagunën e Karavastasë".

Në workshop morën pjesë përfaqësues të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mjedisit, të Noé Conservation, të Parkut Kombëtar Divjakë -Karavasta, peshkatarë të zonës, përfaqësues të shoqërisë civile etj.



TË GJELBËROJMË AMBIENTET PUBLIKE

Filluan punimet për rregullimin e lulishtes në gjimnazin Asim Vokshi në qytetin B.Curri.



Shoqata Alpin, në bashkëpunim me komunitetin dhe nxënësit e kësaj shkolle dhe me financim të REC-ut në kuadër të programit SENiOR-a, ndihmuan për kthimin e gjelbërimit në këtë shkollë të mesme.

Gjithashtu, ata mundësuan dhe blerjen e koshave për të siguruar një mjedis të pastër në ditët në vazhdim.

